



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD PRIŠTINA - OGRANAK GRACANICA

Broj predmeta: 2023:258948

Datuma: 25.10.2024

Broj dokumenta: 06350152

NE EMER TE POPULLIT

K.nr.514/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE, në përbërje të gjyqtarit individual Siniša Borisavljević, me bashkepunetoren profesionale Pranvera Ismaili Zhinipotoku, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit **Z. H.** nga Lipjani, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 41.3 dhe neni 255, par. 2, të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088), më datë 21.08.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Te pandehurit Z.H., i biri i i lindur me dt..... ne Zlakuqan K.Lipjan, tani me vendbanim ne f.Zlakuqan, rruga, Manastirski Kongres nr.37, Lipjan, Ka te kryer shkollen fillore, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë dhe nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër ndaj tij, me **nr.letnj.shqiptarë - Shtetas i Republikës së Kosovës**

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e

Sepse,

Me datën rreth orës ne rrugën Ferizaj-Prishtine ne rrethrotullimin ne Çagllavice ka ndodhe aksident trafiku me lëndime ne mes nje Kamionete dhe nje Autobusi. Deri te aksidenti ka ardhë kur Kamioneta A ka qene duke levizur ne rrugen Llapnaselle-Çagllavice dhe me te arritur ne rrethrotullimin e Çagllavices shoferi me Kamioneten e tij eshte kyçur ne rrethrotullim ne menyre te pasigurt me kete rast i prene rrugen Autobusit B i cili ka qene duke levizur ne rrugen drejtimi Ferizaj- Prishtine dhe ne momentin e aksidentit ka qene ne rrethrotullim ne shiritin e trete me kete rast Autobusi me pjesen e perparme te anes se djathte (skajin e djathte) e godet Kamioneten ne anen e majte ne mes te Kamionetes dhe ne rimorkion e Kamionetes.

Si pasoje e aksidentit shkaktohen e deme materiale dhe lendime trupore

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 41.3 dhe neni 255, par. 2, të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088), për rrjedhojë gjykata duke vendosur në kuptim të nenit në fjalë si dhe në bazë të neneve 3, 7, 8, 9, 13, 27, 29 dhe 35 të ligjit nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, ky

Aktgjykim i shqiptohet të pandehurit ku:

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME TË HOLLA në shumë prej 300 € (treqindeuro), për veprën e kryer e cila i vihet në barre si më lartë.

Miratohet që të paguhet gjoba në dy keste të barabarta prej **150 euro** secila, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për përmbarim.

Gjoben e shqiptuar e pandehura do ta paguaj në afate prej **15** dite nga dita e kur aktgjykimi të merre formën e prërë, nëse kërcënim të përmbarimit të perputhje me dispozitat LPP-s.

I pandehuri, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **10 € (dhjete euro)** në afatin e njëjtë.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi ti dërgohet të pandehurit, ushtruesit të kërkesës dhe të demtuarit.

A r s y e t i m i

Stacioni Policor-NJKRR në Prishtinë e, kësaj Gjykate i ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse **nr..... datë** kundër të pandehurit të lartëshënuar, për shkak të veprës kundërvajtëse e pershkruar sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari, filloi procedurën kundërvajtëse, marrjes në pyetje të pandehurit i cili në deklaratën-mbrojtjen e tij me dt 13.08.2024, në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj për këtë nuk pati nevojë që të administrohen prova tjera

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehurit si dhe kërkesën e stacionit policor, gjyqtari i çështjes erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse, ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqyrtimit të dënimit, gjyqtari muarr parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 35 të Ligjit për Kundërvajtje e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat,

rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, shkallën e përgjegjësisë dhe tiparet personale të tij, pranimin e fajsisë, është penduar dhe ka premtuar se nuk do t'a përsëris mënjë veprim të tillë si dhe faktin se deri me tani nuk ka qene i denuar, andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një denim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë denim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Ne baze të të gjitha te cekurave më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE
Departamenti i pergjithshem, Divizioni per kundervajtje
K.nr. 514/23 nga 21.08.2024

Bashkepunetore Profesionale
Pranvera Ismaili Zhinipotoku

Gjyqtari
Siniša Borisavljević

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe i pandehuri, në afat prej **8 ditësh** nga dita e pranimin të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit- Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.